

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**VENDIM**

**Nr. 30/2022**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 69/2021 “PËR CAKTIMIN  
E ANËTARËSISË SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, neneve 21, pika 2, dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në vendimin e Kuvendit nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit” bëhen këto ndryshime:

I. Deputeti Pandeli Majko caktohet anëtar në Komisionin e Politikës së Jashtme dhe anëtar zëvendësues në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

II. Deputeti Benet Beci nga anëtar zëvendësues caktohet anëtar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

III. Deputetja Etilda Gjonaj caktohet anëtare në Komisionit për Politikën e Jashtme në vend të deputetit Benet Beci.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R E**

**Lindita NIKOLLA**

Miratuar në datën 14.4.2022